




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Bazuar në dispozitat e nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d** dhe nenit 40, paragrafi 40.2, pika **d** të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), në dispozitat e nenit 34, paragrafi 34.1, pika **d** e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, dt. 25.2.2010, dhe propozimit të Grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2015, të dt. 15.12.2014, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 29.12.2014, miratoi

PLANIN
VJETOR TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS

I.

MIRATOHET Plani vjetor i punës së Kuvendit të Komunës së Prishtinës për vitin 2015.

II.

Plani vjetor i cekur në pikën I të këtij vendimi, përmban: numrin e mbledhjeve, muajin në të cilin do të mbahen mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe pikat – temat orientuese që do të shqyrtohen nga ana e Kuvendit të Komunës.

III.

Plani vjetor i punës së Kuvendit të Komunës, me përmbajtjen e cekur në pikën II të këtij vendimi, është si në vijim:

1. Mbledhja I, muaji janar:

- Informatë për gjendjen e sigurisë në komunë;
- Raporti i Kryetarit për situatën ekonomiko-financiare dhe zbatimin e planeve investuese të Komunës për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2014;
- Shqyrtimi i pikave të mbetura nga viti i kaluar;
- Propozimrregullorja për parkingje në komunë;
- Informatë për të punësuarit në Komunë gjatë vitit 2014;
- Informatë për migrimin dhe riatdhesimin e banorëve të komunës për vitin 2014.

Aktivitetet

- Debati publik me qytetarë.

2. Mbledhja II, muaji shkurt:

- Bartja e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2014, në vitin 2015;

- Propozimrregullorja për kushtet e mbajtjes së qenve dhe maceve dhe mënyrën e veprimit në rast të braktisjes apo humbjes së tyre;
- Propozimrregullorja për menaxhimin e varrezave dhe objektit komemorativ;
- Informatë për suksesin e nxënësve në gjysmëvjetorin e parë të vitit mësimor 2014/2015;
- Informatë për ndarjen e bursave për vitin akademik 2014 – 2015;
- Informatë për fillimin e zbatimit të Ligjit për trajtimin e objekteve të ndërtuara pa leje;
- Informatë për aktivitetet e organeve të administratës në funksion të realizimit të Planit për zhvillimin ekonomik të komunës;
- Informatë për personelin arsimor në komunë.

Aktivitetet

- Mbledhje solemne me rastin e Ditës së shpalljes së Pavarësisë së Kosovës.

3. Mbledhja III, muaji mars:

- Shqyrtimi i raportit përfundimtar përmbledhës buxhetor të Kryetarit të Komunës për vitin 2014.
- Shqyrtimi i raporteve të komisioneve komunale të aksionarëve të NPL-ve për vitin 2014;
- Propozimrregullorja për transportin publik;
- Propozimrregullorja për transportin e udhëtarëve me auto-taksi.

4. Mbledhja IV, muaji prill:

- Shqyrtimi i raportit financiar tremujor për periudhën janar – mars 2015;
- Informatë për sigurinë në komunë, me theks të veçantë siguria në shkolla;
- Informatë për funksionimin e transportit lokal;
- Informatë për menaxhimin e varrezave dhe mirëmbajtjen e tyre.

5. Mbledhja V, muaji maj:

- Formimi i grupit punues për hartimin e planit të veprimit për proces transparent të buxhetimit;
- Propozimrregullorja për caktimin e rrjetit të linjave dhe itinerarit të transportit urban dhe urbano-periferik të udhëtarëve me autobusë në territorin e komunës së Prishtinës;
- Informatë për gjendjen në institucionet e kulturës;
- Informatë për mbjelljet pranverore;
- Informatë mbi menaxhimin e mbeturinave në komunë.

6. Mbledhja VI, muaji qershor:

- Rishikimi i buxhetit për vitin 2015;
- Shqyrtimi i Kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2016 – 2018;
- Propozimplani vjetor i punës nga Departamenti i prokurimit për vitin 2016;
- Informatë për gjendjen e furnizim me ujë (Kompania e ujësjellësit rajonale “Prishtina” SH.A.);
- Informatë mbi menaxhimin e hapësirave publike dhe parqeve, përfshirë edhe mbrojtjen e pyjeve në komunë;

Aktivitetet

- Dëgjimet publike rreth Kornizës afatmesme buxhetore 2016 – 2018;
- Mbledhje solemne me rastin e Ditës së Çlirimit të Prishtinës.

7. Mbledhja VII, muaji korrik:

- Raporti i Kryetarit të Komunës për situatën ekonomiko-financiare të Komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të Komunës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2015;
- Shqyrtimi i raportit financiar tremujor për periudhën prill – qershor 2015;
- Shqyrtimi i raportit të Auditorit të Përgjithshëm për Komunën për vitin 2014;
- Informatë për rendin dhe qetësinë në komunë (Policia e Kosovës);
- Informatë për përgatitjen e korrje-shirjeve për kulturat bujqësore – drithërat e bardha.

Aktivitetet

- Debati publik me qytetarë.

8. Muaji gusht:**Pushim****Aktivitetet**

- Organizimi i dëgjimeve publike rreth buxhetit të Komunës për vitin 2016.

9. Mbledhja VIII, muaji shtator:

- Shqyrtimi i projektbuxhetit të Komunës për vitin 2016;
- Shqyrtimi i projektregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2016;
- Shqyrtimi i projektregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale për vitin 2016;
- Informatë për suksesin e nxënësve, përfundimin e vitit shkollor 2014/2015 dhe fillimin e vitit shkollor 2015/2016;
- Informatë për përfundimin e procesit të korrje-shirjeve.

Aktivitetet

- Organizimi i dëgjimeve publike për buxhetin e Komunës për vitin 2016.

10. Mbledhja IX, muaji tetor:

- Shqyrtimi i raportit financiar tremujor për periudhën korrik - shtator 2015;
- Informatë për furnizimin me ujë për periudhën qershor - shtator 2015 (KUR “Prishtina” SH.A.);
- Informatë për fillimin e vitit shkollor 2015/2016;
- Informatë rreth mbjelljeve vjeshtore;
- Informatë për sigurinë në komunë (Policia e Kosovës).

11. Mbledhja X, muaji nëntor:

- Informatë për fillimin e ngrohjes për sezonin dimëror;
- Themelimi i Grupit punues për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2016;

- Informatë mbi ndarjen e subvencioneve;
- Informatë mbi gjendjen në shëndetësi.

12. Mbledhja XI, muaji dhjetor:

- Propozimvendimi për planin vjetor të punës për vitin 2016;
- Informatë për gjendjen në infrastrukturë për vitin 2014.

IV.

Kuvendi i Komunës mban të drejtën që në raste të caktuara, të mbajë mbledhje të jashtëzakonshme apo urgjente.

IV.

Për zbatimin e pikës III dhe IV të këtij vendimi, do të kujdesen: Kryesuesi i Kuvendit, Kryetari i Komunës, drejtorët e drejtorive, drejtorët e institucioneve shëndetësore dhe arsimore dhe Komisioni komunal i aksionarëve për ndërmarrjet publike lokale.

VI.

Ky plan hyn në fuqi tetë (8) ditë pas publikimit të tij në ueb-faqen e Komunës dhe në tabelën e shpalljeve të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01. nr. 031-288288, më 31.12.2014

KRYESUESI I KUVENDIT
Halim Halimi, jur. i dipl.

A r s y e t i m

Kuvendi i Komunës funksionon në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale, ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore që rregullojnë vetëqeverisjen lokale, dhe në bazë të Statutit të Komunës së Prishtinës.

Sipas LVL – së, Kuvendi i Komunës nuk e delegon përgjegjësinë e tij lidhur me marrjen e Vendimit për planin vjetor të punës së tij (neni 40, paragrafi 40.1, pika d).

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 1.12.2014, ka themeluar Grupin punues për hartimin e propozimplanit të Kuvendit të Komunës për vitin 2015.

Grupi punues ka mbajtur takime më 12 dhe 15 dhjetor 2014, dhe pas finalizimit të këtij propozimplani, ai është propozuar t'i dërgohet në procedurë të mëtejme Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës.